

KËRKESË PËR FSHIRJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në përputhje me nenin 21 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.42/2020, 294/21) dhe 101/25), Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale u mundëson subjekteve të të dhënave personale realizimin papengesë të të drejtës së tyre për të fshirë të dhënat personale.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale do të ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme me qëllim për t'iu përgjigjur kërkesës së subjektit brenda 30 ditëve nga pranimi i Kërkesës, përkatësisht nga marrja e informacionit shtesë nëse Kërkesa e paraqitur fillimisht është e paqartë ose e paplotë.

1. Të dhëna për parashtruesin e Kërkesës

Emri dhe mbiemri	
Kategoria e subjektit (punonjës/e bashkëpunëtor/e i jashtëm, aplikant/e për punë, pjesëmarrës/e në aktivitete)	
Adresa	
Numri i telefonit për kontakt	
e-mail adresa	

2. Arsytet për fshirjen e të dhënave personale

Në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, në mënyrë që t'i mundësojë subjektit të të dhënave personale realizimin e të drejtës për fshirjen e të dhënave personale, duhet të përmbushen disa kushte ligjore. Ju lutemi duke rrethuar shënoni arsyen pse po kërkon fshirjen e të dhënave tuaja personale:

- Mendoj se të dhënat e mia personale nuk janë më të nevojshme, përkatësisht, qëllimet për përpunimin e tyre tashmë janë përmbushur;
- Nuk pajtohem më që ju të përpunoni të dhënat e mia personale;
- Kam ankimim të përpunimit të të dhënave;
- Mendoj se të dhënat personale janë përpunuar në mënyrë të paligjshme;
- Unë jam i/e mitur, përfaqësoj një të mitur ose isha i mitur në kohën kur të dhënat e mia personale u mbledhën fillimisht.

3. Cilat të dhëna personale kërkon të fshihen?

Ju lutemi cekni se për cilat të dhëna personale kërkon të fshihen. Ju lutemi të na jepni në detaje të gjitha detajet përkatëse që do të na ndihmojnë të identifikojmë të dhënat personale për të cilat kërkon fshirje (numri i kontratës, data dhe mënyra e dhënies së pëlqimit, linku aktiv nëse kemi të bëjmë me të dhënë të shpallur publikisht dhe të ngjashme.)

Në rastet kur fshirja e të dhënave personale pengon përmbushjen e detyrimeve ligjore, zbatimin e procedurave interne për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ose është në kundërshtim me detyrime kontraktuale, e njëjta nuk do të zbatohet. Në raste të tilla, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale do t'ju njoftojë menjëherë dhe detajisht për vendimin e marrë.

4. DEKLARATË

Unë, _____, konfirmoj se kam lexuar dhe kuptuar informacionin e përmbajtur në këtë Kërkesë dhe se informacioni që kam dhënë është i saktë. Unë kuptoj që Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale mund të kërkojë konfirmim për identitetin tim dhe ose identitetin e subjektit të të dhënave personale si dhe informata shtesë që do ndihmojnë në identifikimin e të dhënave për të cilat kërkoj të fshihen.

Nënshkrimi

Data

Dokumentet bashkangjitur Kërkesës:

- Dëshmi për identitetin e subjektit të të dhënave personale (kur parashtuesi është person i autorizuar)
- Autorizim nga subjekti i të dhënave personale
- Arsyetim i Kërkesës (shpjegim i detajuar në përputhje me pikën 3)